

U D H Ë Z I M
Nr. 1, datë 12.1.2002

**PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONEVE TË QENDRAVE TË VOTIMIT KUR
NUK ARRIHET KUORUMI I NEVOJSHËM PËR ZGJEDHJET PËR KËSHILLIN E
KOMUNËS KOLSH TË QARKUT TË LEZHËS**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, asistuar nga sekretarja Enkeleda Dollaj, në mbledhjen e tij të datës 12.1.2002 me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Pandeli Varfi	Anëtar
Tomor Malaj	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Igli Toska	Anëtar

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur:

U D H Ë Z O N:

1. Nëse deri datën e zgjedhjeve Komisioni Zgjedhor i Qeverisjes Vendore të Komunës Kolsh nuk arrin të ngrejë qendrat e votimit sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 të Kodit Zgjedhor apo nëse nuk arrin të krijojë kuorumin e nevojshëm për realizimin e procesit të vendimmarrjes dhe organizimit e mbarëvajtjes së zgjedhjeve në qendrën e votimit, atëherë në datën e zgjedhjeve Komisioni Qendror i Zgjedhjeve emëron menjëherë anëtarët e nevojshëm për plotësimin e kuorunit.

2. Plotësimi i kuorunit për anëtarët e komisionit të qendrave të votimit të bëhet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me propozim të partive që kanë marrë më shumë vota pas shtatë partive të para për zgjedhjet për organet e pushtetit vendor të vitit 2001, e përkatësisht:

- Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut
- Partia Lidhja Fshatare Shqiptare

3. Nëse përsëri nuk plotësohet kuorumi i nevojshëm për realizimin e procesit të zgjedhjeve në qendrën e votimit, atëherë plotësimi i kuorunit të bëhet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me propozim të partive politike që kanë marrë vota në zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001, të cilat nuk kanë përfaqësues në qendrën e votimit dhe përkatësisht:

- Partia Demokrate
- Partia Bashkim Demokrat Shqiptar
- Partia e Komunistëve të Bashkuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Ilirian Celibashi